

# SPECIFIKIME TEKNIKE

PROJEKT - ZBATIM:

**"STUDIM PROJEKTIM I PUNIMEVE PER FURNIZIM  
VENDOSJE DYER DRURI NE OBJEKTET SHKOLLORE"**

Projektues: O.E. "SIRE-ALB" sh.p.k



## PERMBAJTJA

### TË PËRGJITHSHME

- 1.1-Te pergjithsme
- 1.2-Njesite matese
- 1.3-Grafiku I punimeve
- 1.4-Punime te Gabuara
- 1.5-Fotografimi ne Vendin punimit
- 1.6-Mbrojtja e punes edhe publikut
- 1.7-Mbrojtja e ambientit
- 1.8-Transporti edhe magazinimi I materialeve
- 1.9-Dyer te brendshme druri
  - I. Kasa
  - II. Fashatura
  - III. Fleta e derës
  - IV. Mbushja e brendshme
  - V. Brava
  - VI. Mentasha 7.Dorezat e derës
  - VII. Xhami
  - VIII. Boja e derës
  - IX. Hojet termoizoluese
  - X. Ngjitësi i brendshëm



### 1.1 Te pergjitheshme

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesuese te detajeve te dhena ne Kushtet e Kontrates. Te gjithe materialet dhe elementet e perdorur nga zbatuesi duhet te kontrollohen dhe aprovohen nga grupi i projektimit. Nese materialet dhe elementet nuk jane te aprovuar nga grupi i projektimit zbatuesi rrezikon zevendesimin e tyre me ato te aprovuara.

### 1.2 Njesite matese

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m<sup>2</sup>, m<sup>3</sup>, Km, N (Njuton), Mg (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “.”.

### 1.3 Grafiku i punimeve

Kontraktuesi duhet t'i japë supervizorit një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në ndërtim deri në mbarim të punës. Informacioni që mban supervizori duhet të përfshijë: vizatime që tregojnë rregullimin general të ambienteve të godinës dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim; detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme; plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë për ndërtim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim, detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo të kualifikuar si dhe supervizionin e punimeve. Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga supervizori, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga supervizori gjatë zbatimit të punimeve.

### 1.4 Punime te Gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

### 1.5 Fotografite ne vendin e punimit

Sipermarresi duhet te beje fotografi me ngjyra sips udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve ne vendet e punes per te demonstruar kushtet e punes perpara fillimit, progresin gjate punes se ndertimit dhe mbas perfundimit te punimeve. Nuk do te behen pagesa per fotografimin e vendit te punimeve pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbuloohen nen koston administartive te Sipermarresit.



## 1.6 Mbrojtja e punes dhe e publikut

Sipermarresi do te mare masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar dhe te jetes publike si edhe te pasurive ne dhe rreth vendit te ndertimit. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikushme, kodeve te ndertesave dhe te ndertimit do te respektohen. Makinerite, pajisjet dhe cdo rrezik do te kqyren ose eliminohen ne perputhje me masat paraprake te sigurimit.

## 1.7 Mbrojtja e ambientit

Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjithe veprimet e mundshme per te siguruar qe ambjenti i punes te ruhet dhe qe linjat e ujit, toka dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera. Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Mbikqyresi i Punimeve, mund te coje ne nderprerjen e kontrates.

## 1.8 Transporti dhe magazinimi i materialeve


Transporti i cdo materiali nga Sipermarresi do te behet me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjithe ngarkesa te jete e siguruar. Ndonje makine qe nuk ploteson kete kerkese ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqet nga kantjeri. Te gjitha materialet qe sillen nga Sipermarresi, duhet te stivohen ose te magazinohen ne menyre te pershtateshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe ne dispozicion, per tu kontrolluar nga Mbikqyresi i Punimeve ne cdo kohe.

## 1.9 Dyer te brendshme druri

Furnizimi dhe instalimi i dyerve të brendshme prej materiali dru dimensionet e të cilave jepen nga Porositësi, përbëhet nga:



**DERA E RE QE DO TE VENDOSSET NE OBJEKT**  
**SHKALLA: 1/30**



1. Kasa
2. Fashatura
3. Fleta e derës
4. Mbushja e brendshme
5. Brava
6. Mentsha 7. Dorezat e derës
8. Xhami
9. Boja e derës
10. Hojet termoizoluese 11. Ngjitësi i brendshëm

**1.1 Kasa e derës** perbehet nga material drusor listellare, i cili formohet nga elemente druri tengjitur me njeri tjetrin dhe kompesate shumështrësore. Pasi perpunohet ne dimensionin e kerkuar, kasa e derës kalon ne lysterjen me boje speciale kundrazjarrit.

Materiali i saj eshte shume i forte si ndaj goditjeve, rezistent ndaj lageshtise dhe me cilesi te mira zjarrdurueshmerie.

Trashesia e kases eshte 4cm, dhe gjeresia 12cm.

Ne kases e derës vendoset nje guarcion antizjarr qe ne rast zjarri fryhet dhe bllokton hapësirë kase-dere. Dimensioani i guarcionit eshte 10 x 1 mm.

**1.2. Fashatura e derës** pergatitet nga material multistrato (fletë druri të ndërthurura) i cili eshte rezistent ndaj lageshtires dhe me cilesi te mira zjarrduruese, pasi perbehet nga disa kompesata telidhura me njera tjetren.

Pasi pritët ne dimensionin e kerkyar ai lyhet me boje speciale kundra zjarrit qe siguron kerkesate porositesit.

**1.3. Fleta e derës** eshte elementi baze funksional me gjeresi 45 mm.

Ajo pergatitet nga nje telajo prej dru bredhi me lageshti 11% dhe me seksion 3.6 x 3.6 cm ose 3.8 x 3.8 cm, me gjatesine dhe gjeresine e kerkuar.

Kjo telajo mbushet me lesh guri me karakteristikat qe jep porositesi.

Mbi telajo vendosen dy panele MDF me trashesi 4mm kundra uji qe eshte material i cilesise selarte kunder lageshtise, gervishtjes dhe rezistent ndaj nxehtesise.

Pasi formohet ky panel sandwich, fleta e derës kalon ne operacionet e perpunimit ku me njevendosje hapen vendet e bravave, dorezave dhe menteshave.

#### **1.4 Mbushja e brendshme e derës**



Mbushja e brendshme e derës duhet të përbëhet nga panele MDF për përdorim të brendshëm të cilat janë të prodhuara përmes një procesi presimi për efekt të shmangjes së lagështirës dhe rezistencës ndaj zjarrit.

Karakteristikat teknike te siperfaqes

- Rezistenca ndaj lagështirës: > Niveli 4 sipas EN 14323 ose ekuivalente
- Rezistenca ndaj çarjes: > klasa 3 sipas EN 14323 ose ekuivalente
- Rezistenca ndaj nxehtesise: Klasa B sipas EN 12722 ose ekuivalente
- Tendenca per te ruajtur papasterti: > Niveli 4 sipas UNI 9300 ose ekuivalente

Perberja:

- Dru: 79-89 %
- Ngjites: 7-10%
- Uje: 4-11%
- Sulfat Amoniumi: 0.2%
- Densiteti: 700-800 kg/m<sup>3</sup>
- Lageshtia: 4-11%
- Perbeja e Reres: 0,05% Tolerancat e Dimensioneve:
- Trashesia brenda panelit: +/- 0.3mm
- Gjatesia dhe gjeresia: +/- 5mm

| Vlerat nominale nga grupi i trashësisë    | Standardi              | >3mm<br>≤4mm | >4mm<br>≤6mm | >6mm<br>≤9mm | >9mm<br>≤12mm | >12mm<br>≤19mm | >19mm<br>≤30mm | >30mm  |
|---|------------------------|--------------|--------------|--------------|---------------|----------------|----------------|--------|
| Moduli i elasticiteti N / mm <sup>2</sup> | EN 310 ose ekuivalente | > 3000       | > 2700       | > 2700       | > 2500        | > 2200         | > 2100         | > 1900 |
| Lidhjet e brendshme N / mm <sup>2</sup>   | EN 319 ose ekuivalente | ≥ 0,65       | ≥ 0,65       | ≥ 0,65       | ≥ 0,60        | ≥ 0,55         | ≥ 0,55         | ≥ 0,50 |
| Forca përkulëse N / mm <sup>2</sup>       | EN 310 ose ekuivalente | ≥ 23         | ≥ 23         | ≥ 23         | ≥ 22          | ≥ 20           | ≥ 18           | ≥ 15   |
| Zmadhim 24 orë                            | EN 317 ose ekuivalente | ≤ 35%        | ≤ 30%        | ≤ 17%        | ≤ 15%         | ≤ 12%          | ≤ 10%          | ≤ 8%   |

### 1.5 Brava e derës

Brava duhet te jete automatike me fishek jo më pak se 3 (tre) çelësa Shuli duhet te jete magnetik ne menyre qe te kete operim pa zhurmeLartesia totale: 185-190mm

Gjatesia: 58-62 mm

Gjeresia: 13-14 mm

Gjuhëza: 12x23 mm ,



hapja: 10-11 mm

Shuli: 6x30 mm, hapja: 20-

21mm Materiali: Çelik

### 1.6 Menteshat

Menteshave duhet të përbëhen nga material çeliku inoks ose çeliku të veshur me shtresë bronxi, dhe sipas standartit dhe cilësisë CE. Materiali i çelikut duhet të sigurojë qëndrueshmërinë e lartë të menteshave, mos thyeshmërinë e tyre ndaj goditjeve mekanike, elasticitetin e duhur të menteshave etj. Menteshat duhet të jenë të përbëra prej:

- Kunji me fileto;
- Vidat e çelikut që përdoren për mberthimin e tyre në objekt.

Kunjat e mësipërm duhet të levizin lirshëm tek njëri tjetri duke bërë të mundur një lëvizje sa më të lehtë të kornizës së derës ose të dritares kundrejt kasës së tyre. Menteshat që përdoren për dyert përbëhen prej kunjavetë përmendura mësipër dhe vidave metalike për mbërthimin e tyre. Kunjat me fileto tip mashkull duhet të jenë me diametër  $d=14-16$  mm.

#### Specifikimet

- Përdorimi: Per dere druri
- Materiali: Inoks
- Lartësia: 80-82 mm
- Diametri  $\varnothing$  i pjeses së filetuar: 13-14 mm
- Diametri  $\varnothing$  i pjeses së filetuar: 15-16 mm
- Lartësia e filetimit: 1,8-2 mm
- Nr. i kapesëve: 2 të filetuara, 2 të lemuara
- Kapeset të jenë të siguruara mire në trupin e menteshes nga një unazë.
- Kapaciteti maksimal mbajtës: 90-100 kg
- Rregullimi i presionit vertikal: 4-5 mm
- Të jete i rregullueshem në 3 akse
- Të jete e markuar me Marken CE

### 1.7 Dorezat e dyerve

Dorezat e dyerve duhet të jenë të njëjta në të gjitha dyert që do të vendosen. Në mënyrë që të plotësohet ky kusht duhet që këto doreza të jenë të tilla, që mund të përdoren si në ambientet ethata ashtu edhe në ato me lagështirë.





Kriteret që duhet të plotësojnë dorezat e dyerve:

a) Të kenë shkallë të lartë sigurië në përdorim (jetëgjatësi gjatë përdorimit të shpeshtë), Jetëgjatësia e dorezave varet kryesisht nga materialet me të cilat janë prodhuar ato, si dhe nga mënyra e lidhjes së dorezës me elementët e tjerë (cilindrit, bravës etj.) Për këtë sugjerohet që të zgjidhen doreza, të cilat janë prodhuar me material të fortë dhe rezistent.

b) Të garantojnë rezistencë momentale ndaj ngarkesave (të sigurojë qëndrueshmëri në rastet e keqpërdorimit: varjet, goditjet, përplasjet etj), duke patur parasysh përdoruesit e këtyre dorezave, duhet që ato të kenë koeficientë të lartë qëndrueshmërie në ngarkesë, pra duhet ti rezistojnë peshës së fëmijëve tek doreza. Sipas normave Evropiane (DIN) ekzistojnë dy klasa qëndrueshmërie ku mjafton të plotësohet njëra prej tyre.

c) Të mos shkaktojnë dëmtime fizike gjatë përdorimit.

Përsa i takon kësaj pike duhet të themi se meqënëse keto doreza do të montohen në dyert e kopshteve, shkolla fillore, tetëvjeçare e të mesme, pra do të përdoren nga fëmijë duhet që dorezat të zgjidhen të tilla, që të mos shkaktojnë dëme fizike tek fëmijët.

Specifikimet


- Materiali: Alumin
- Grada e fortësisë: 3
- Rezistenca ndaj korrozionit: 4-5
- Trashësia e derës: 35 – 45 mm
- Vidat: 3,5x17mm
- Diametri i Rozetes: 52 mm
- Gjatesia e dorezes: 125-130mm
- Standartet që duhet të përmbushë: DIN EN 1906: 370140A ose ekuivalente.

### 1.8 Finitura e xhamit.

Permasat e finitures se  
xhamit: Trashësia e  
xhamit: ~6mm Hapesire  
drite : 170x750 mm  
Permasat e xhamit :  
200x780 mm



Permasat e finitures: 245x825 mm



#### Korniza:

- Materiali: Dru
- Qoshet e gërshetuara dhe të ngjitura me gozhde dheme silicon.
- Për përdorim me trashësi deri në 6 mm
- Projektuar për përdorim ne dyer druri
- Madhësia e rendit është e barabartë me madhësinë e prerjes - Madhësia e xhamit është 200x780 mm, Xhami i dukshëm është 170x750mm
- Madhësitë e personalizuara
- Ngjyra speciale të veshjes e pershtatur me ngjyrene deres



### **Specifikimet e xhamit:**

Xhami duhet të jetë i laminuar dhe pjesë e llojit të xhamave të sigurtë. Xhami i laminuar në rastetë thyerjes nuk shpërndahehet në pjesë të imët por mbeten të lidhura me polivinil-butiral (PVB).

Xhami i laminuar është i përberë nga dy apo më shume pllaka të qelqit të lidhura në mes tyre nëtërë sipërfaqen e tyre me ndihmën e një apo më shumë fletëve PVB), karakteristikat e të cilës janë elasticiteti, tejdukshmëria, fortësia si dhe adezioni në xham. Fleta e cila gjendet në mes tëxhamit duhet të jetë e tejdukshme.

### **Specifikimet teknike të xhamit;**

Xham i tejdukshëm dhe i laminuar ku trajtimi me nxehtësi (temperimi) rrit elementët e sigurisë në rastet e thyerjes duke ndaluar shpërndarjen në mjedis të grimcave të vogla. Rekomanduar për të gjitha dyert që vendosen në ambjentet e godinave arsimore.

- CAT II me ndikim (xham i sigurtë)
- Transmetimi: 86%
- Vlerësimi i zjarrit: Asnjë
- Trashësia: ~6mm



### **1.9 Boja e derës**

Bojë poliuretani me cilësi të lartë poliuretani, ekologjike me bazë uji. Të jetë çertifikuar sipas kriterëve të Bordit të Ecolabelimit të Bashkimit Evropian (EUEB) EN 71-3: 2013 ose ekuivalente. Është aplikuar lehtësisht dhe jep një sipërfaqe të lëmuar pa furçë dhe / ose shenja të përbashkëta. Të ketë, **qëndrueshmëri** ndaj larjes së shpeshtë. Të jetë pa erë gjatë aplikimit të saj sepse nuk përmban amoniak apo substanca të tjera të rrezikshme, siç janë hidrokarburet aromatike, formaletaldehidet e lira, metalet e rënda ose alkilfenoletoksilatet.

Aplikimi



Hollimi i bojës 5-10% me ujë në temperatura nën 5°C, mbi 35°C.

#### Norma e perhapjes

9 - 13 m<sup>2</sup> / Lt sipas ISO 6504-1 ose ekuivalente për shtresën në sipërfaqe të përgatitur sipas kushteve teknike.

Përmbajtja e komponimeve organike të paqëndrueshme VOC (Volatile organic compounds);

Vlerat kufi të përmbajtjes së VOC në produkt sipas standarteve të miratuara të BE-së (sipas përcaktimeve në Direktivën 2004/42 / KE, Aneksi 2) për këtë produkt të jetë: tipi WB→VOC < 130 g / L.

#### Karakteristikat teknike

- Viskoziteti - 95 +/- 10 KU (ASTM D 562, 25°C)
- Densiteti - 1.27 +/- 0.02 Kg/L (sipas standartit ISO 2811 ose ekuivalente) për tebardhe
- Shkelqimi - >75 njesi në 60° - Shkelqimi (sipas standartit ISO 2813 ose ekuivalente) 20-40 njesi në 60° - Saten (sipas standartit ISO 2813 ose ekuivalente)

<15 njesi (mat) (sipas standartit ISO 2813 ose ekuivalente)

#### 1.10 Hojet termoizoluese

##### Shtresa e sipërme

- Pësia: 440 g/m<sup>2</sup> (minimumi: 426 , maksimumi: 452)
- Lageshtia: 7,5% (minimumi 6% , maksimumi 10%)
- Thithja e ujit: maksimumi 155 g/m<sup>2</sup> Standartet:
- Pësia: NF EN ISO 536 ose ekuivalente
- Thithja e ujit: NF EN 20535 ose ekuivalente

##### Shtresa e poshtme

- Pësia: 300-310 g/m<sup>2</sup>
- Trashësia: 440-450µm
- Dendësia: 1,45-1.50 cm<sup>3</sup>/g
- Shperthimi: 730-750 kPA
- Ashpersia: 1650-1750 ml/min
- SCT: 4,5-4,7 kN/m



- Thithja e ujit 55 g/ m<sup>2</sup>

### Shtresa Baze (pjesa qendrore)

Trashësia: 21 mm

Pesha: 170 g/m<sup>2</sup>

- Transmetimi: 86%
- Vlerësimi i zjarrit: Asnjë
- Trashësia: ~6mm

#### 1.11 Ngjitësi i brendshëm

##### Fushat e Aplikimit

- Mbështjellja e drurit dhe materialeve me bazë druri
- Gjithashtu i përshtatshëm për substrate të tilla si chipboard dhe MDF

##### Vetitë e Ngjitësit

- Baza: EVA kopolimer
- Pesha specifike: 1.22-1.28 g/cm<sup>3</sup>
- HBDB V-II: në 180 gC: 50,000 ± 10,000 mPa /s
- Indeksi i shkrirjes sipas standartit DIN 53 735 ose ekuivalente (MF (150/2, 16): 120 ± 20g/10 min.
  - Pika e zbutjes: 95 ± 5 gC
  - Temperatura e procesit: 190-200 gC
  - Temperatura e aktivizimit: 180-200 gC
  - Sasia e aplikimit: 80-130 g/m<sup>2</sup>

#### 1.12 2.0 Llaç i gatshëm

Llaç i gatshëm është material mbushës për mure tulle ose blloqe betoni, për ambiente të brendshme ose të jashtme, i cili është në formë pluhuri me bazë çimento, gelqere, rere guri rezina sintetike dhe aditiv.



**KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:**

Forma: pluhur

Paketimi: Në thasë 15-25 kg

Konsumi për formatet e vogla:

2-3 kg / m<sup>2</sup> Konsumi për

formatet e mëdha: 4-5kg / m<sup>2</sup>

Koha e ruajtjes:  $\geq$  12 muaj nga

data e prodhimit Dendësia: 1.7-

1.9 gr / cm<sup>3</sup>

Reagimi ndaj zjarrit:

Klasa A1 Kërkesa për

ujë: 7-8 litra ujë për 25

kgpH e përzierjes:

12.5-13.5

Temperatura e aplikimit: + 5 °

C deri + 35 ° C Koha e

rregullimit: 35-40 min

Tharja në mure: Pas

8 deri në 12 orë

Tharja në dysHEME:

Pas 24 orësh

Forca ngjitëse pas 28 ditësh:

$\geq$  1 N / mm<sup>2</sup> Forca ngjitëse

pas zhytjes në ujë:  $\geq$  1 N /

mm<sup>2</sup>

Forca ngjitëse pas reaksionit të ngrohjes:  $\geq$  1 N / mm<sup>2</sup>



Forca ngjitëse pas cikleve të ngrirjes së

shkrirjes:  $\geq 1 \text{ N / mm}^2$  Forca ngjitëse pas 30

minutave:  $\geq 0.5 \text{ N / mm}^2$

Rrëshqitëse:  $\leq 0,5 \text{ mm}$

### 3. Boja hidroplastike.

Boja hidroplastike të jetë bojë me cilësi të lartë, ekologjike për përdorim të brendshëm. Ajo duhet të plotësojë kriteret e Bashkimit Evropian për Eco-Label. Të jetë antibakteriale dhe hipoalergjike e provuar kjo me testime nga laboratorë të akredituar. Të jetë rezistente ndaj larjeve.

Të dhënat teknike të bojës:

Lloji: Bojë ekologjike e bazuar në PVA kopolimer (rezina).  
Pesha specifike: 1,44 - 1,52  $\pm$  0,02 gr/cm<sup>3</sup> (të plotësojë standartin ISO 2811 ose ekuivalente) Metoda e aplikimit: Furçë, rrul.  
Hollimi: 5-10% me ujë të pastër.  
Fuqia mbuluese: 10-12m<sup>2</sup> për litër për shtresë në sipërfaqe të përgatitur paraprakisht. Tharja: 1 - 3 orë. Koha e tharjes varet nga kushtet e motit (lagështia, temperatura). Ngjyra: Ajo është në dispozicion në të bardhë dhe në numër të pakufizuar të ngjyrave. Magazinimi: Ruhet në temperaturë 5 °C - 40 °C.

Përmbajtja e lëndëve organike Volatile (VOC) të jetë sipas vlerave të lejuara maksimale sipas BE . Vlera e VOC < 5 gr / litër, i gatshëm për përdorim, në kategorinë A/a për Tavane, Mure të brendshme dhe të jashtme.

Bojërat e paraqitura nga operatori ekonomik ofertues duhet të përmbushin standartin ISO 11998 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj fërkimit.

Bojërat e paraqitura nga operatori ekonomik ofertues duhet të përmbushin standartin ISO 6504-3 ose ekuivalente lidhur me aftësinë mbuluese.

Bojërat e paraqitura nga operatori ekonomik ofertues duhet të përmbushin standartin ISO 16000-9 ose ekuivalente lidhur me emetimin e komponentëve organikë të paqëndrueshëm (VOC).

## 2. Specifikimet teknike e derës së zjarrit

### Standardi dhe certifikimi:

Dyert antizjarr te vleresuara me izolim ndaj zjarrit te zbrazeta sipas IS 3614, te testuar per 60, 90, 120 minuta qendrueshmeri, integritet dhe izolim 30 minuta, duke permbushur kriteret e testimit te IS/ISO 834-1. Celiku i galvanizuar i presuar qe konfirmon IS 277 me specifikimet e meposhtem.

### 2.1 Korniza e deres:

Korniza e deres duhet te jete profil i vetem me zhveshje me permasa 125x55 mm, i bere nga flete celiku e galvanizuar me trashesi minimale 1.60mm. Kornizat duhet te jene te perdredhura dhe te montuara ne terren me vete-skada. Kornizat duhet te kene ndertim sistemin e vulosjes me brazda dhe duhet te jene te pajisura ne vend me guarnicion EPDM te vleresuar me zjarr si standard. Te gjitha dispozitat duhte te fshihen, te shpohen dhe te pergjohen per marrjen e pajisjeve te pershtatshme. Kornizat duhet te pajisen me mbajetse te pllakes se pasme dhe fksues ankorimi per instalim ne nje hapje muri te perfunduar te suvatuar. Kornizat duhet te mbushen me pufke e vleresuar me zjarr dhe boshlleqet duhet te vulosen me izolues silikoni

### 2.2 Mentasha

Mentasha duhet te kene shenjen CE kundrejt EN 1935 per perdorim ne montimet e dverve me dru zjarri 30-minutesh dhe te kene nje shkalle te pershtatshme per madhesin/peshen e deres se kerkuar.

### 2.3 Brava dhe shul

Bllokimet/kycet nuk jane te nevojshme. Kur montohen bravat/kycet duhet te kene Marken CE per perdorim 30 minuta dyert e zjarrit prej druri

### 2.4 Pajisje Vete Mbyllese

Te gjitha dyert kerkohen te pajisen me nje pajisje vetembyllese te certifikuar nga CERTIFIRE. Perjashtim bejne dyert qe mbahen te mbyllura, si p.sh. dyert e hyrjes ne sherbim.

Shenim: Mbyllesit me mekanizma te hapjes mekanike nuk lejohen te perdoren. Rregulloret e ndertimit mund te identifikojne vendodhjet brenda vendodhjeve shtepiake ku pajisjet vete-mbyllese nuk jane te detyrueshme.






Mbyllesit duhet te kene shkalle fuqie te pershtatshme per madhesit e fleteve, me kusht qe mbyllesi te kete aftesine per te mbyllur deren nga cdo kend dhe kunder cdo shul/ose vule te montuar. Sa me afer duhet te kete aftesine per te siguruar nje force mbyllese me madhesi minimale 3. Aty ku dyert nuk mbyllen, duhet te ruhet madhesia minimale 3.

## 2.5 Boja

Te gjitha dyert dhe kornizat duhet te jene te lyera me boje elektrostатike pluhur me pjekje dhe duhet te kene kaluar te pakten 500 ore prove me sperkatje me kripe.



Punoi:  
O.E. "SIRE-ALB" sh.p.k  
Perfaqesues:  
Sibjon ÇOBAJ

